

URDHËR
Nr. 154, datë 19.5.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës “d” të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” si dhe të pikës 3 të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave administrative që zotëron Z. Alqi Bllako Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Drejtorit të Drejtorisë Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve Znj. Alba Thoma me përjashtim të detyrave të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin financiar.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga znj. Alba Thoma Drejtor i Drejtorisë Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve nga data 23.5.2017 deri më datë 20.6.2017.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Alqi Bllako Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe znj. Alba Thoma Drejtor i Drejtorisë Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka